

KOMPONENTI NR. 8.

REKOMANDIME TË DALA NGA STUDIMI PEDOLOGJIK PËR KLASIFIKIMIN E TOKAVE SIPAS SISTEMIT NDËRKOMBËTAR TË FAO/UNESCO-S (MALËSI E MADHE 2008)

1. Të bëhet një vlerësim i resurseve tokësore në shkallë rrethi e vendi nëpërmjet karakterizimit të këtyre tokave nga studimi pedologjik.
2. Nëpërmjet këtij studimi të vendosen baza shkencore për marrje dhe dhënie eksperience midis shteteve dhe shkencëtarëve të ndryshëm, midis zonave me klimë të ngjashme për transferimin e teknologjive bashkëkohore nga një shtet në tjetrin dhe nga një zonë në tjetrën.
3. Të përcaktohet një skelet i përbashkët pune për kërkime shkencore më të hollësishme në fushën e shkencës së tokës.
4. Të shërbejë si një dokument bazë për punën kërkimore shkencore të dale nga studimet pedologjike ku do tu shërbejë shkencëtarëve të ndryshëm brënda dhe jashtë vendit, institucioneve të interesuara, universiteteve si dhe fermerëve në fushën e përdorimit dhe mbrojtjes së resurseve tokësore në shkallë vendi.
5. Të shërbejë si fuqizim i kontakteve ndërkombëtare në fushën e shkencës së tokës në mes shkencëtarëve dhe fermerëve.
6. Të dhënat e studimit dhe të hartës përkatëse të përbëjnë konceptet e sotme me interes kombëtar për degradimin e tokës, erozionin, pjellorinë e tokës, pakësimin e potencialeve prodhuese sidomos nga keqpërdorimi i tokës ose ulja e sipërfaqes së punueshme nga ndërtimet.
7. Harta e tokës të shërbejë për vendosjen e praktikave të drejta të punës përsa i përket ritmeve të zhvillimit dhe adaptimit të përdorimit të tokës në nivel vendi dhe zone.

8. Harta e tokës bën të mundur gjithashtu edhe përcaktimin e zonave të njëjta agro-ekologjike, për përshtatshmërinë e kultivimit të bimëve bujqësore më të përshtatshme për çdo tip toke. Kjo ndikon në dhënien dhe marrjen e eksperiencës midis zonave të ngjashme, çka shërben për kompletimin e zonave me potencial të ndryshme prodhuese.
9. Në studimet pedologjike të aplikohet procedura e përcaktimit të fraksioneve dhe trekëndëshi i tekstures i propozuar nga USDA.
10. Të dhënat e këtij studimi të shërbejnë si një material bazë për punën studimore të mëtejshme në fushën e trajtimit shkencor të tokës.
11. U rekomandojmë institucioneve shtetërore që në hartimin e politikave të përdorimit të tokës ti referohen treguesve që shprehin cilësinë dhe përshtatshmërinë e tokave dhe se strategjia e zhvillimit kombëtar të bujqësisë të synojë në uljen në minimum të degradimit të tokës.
12. Për qëllime specifike të përdorimit të tokës është e domosdoshme kryerja e studimeve tokësore më të detajuara dhe kartografimi në shkallën më të madhe.
13. Gjendja e aktuale e resurseve tokësore në vendin tonë e bënë të domosdoshme, ndërgjegjësimin e përdoruesve të tokës për ruajtjen e saj dhe shtimin e pjellorisë, si dhe inkurajimin e tyre nëpërmjet mbështetjes financiare dhe rregullimit ligjor të praktikave të përdorimit të tokës.
14. Monitorimi dhe vlerësimi cilësor i burimeve tokësore përbën një bazë për kontrollin e tendencave (të ndryshimit të sipërfaqes, pjellorisë, ndotjes, degradimit etj.) dhe përgatitjen e kushteve paraprake për një përdorim të qëndrueshëm të tokave në Shqipëri.
15. Koordinimi dhe unifikimi i aktiviteteve studimore dhe udhëzuesve përkatës midis rretheve të ndryshme të përfshirë në zonën e studimit, të bazohet në këtë studim.

16. Ekstensionistët dhe specialistët e bujqësisë mund ti referohen këtij studimi në transferim dhe aplikimin e teknologjive të reja të kultivimit dhe përmirësimit të tokës.
17. Në tokat e degraduara dhe në ato me faktor kufizues për prodhimin është i domosdoshëm aplikimi i sistemeve të bujqësisë ekstensive si dhe i teknologjive bashkëkohore të përmirësimit të tyre.
18. Studimi mund të shërbejë si dokument bazë në punën kërkimore shkencore në fushën e tokës për një shfrytëzim sa më racional dhe efektiv.
19. Transferimi dhe implementimi i teknologjive bashkëkohore të kultivimit të bimëve dhe trajtimit shkencor të tokës mund t'i referohet me sukses rezultateve të këtij programi.

Kordinatori i Programit

Prof. Dr. Kol CARA

Fushë Krujë me, 09.02.2009